



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 17/1 Prot.

Tiranë, më 06.01.2025

**V E N D I M**

Nr. 3, datë 06.01.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 188, datë 11.09.2024, e paraqitur nga z. H.M dhe z. A.M kundër Kompanisë që ofron shërbimin në linjën e transportit urban Mollas-Cërrik, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ndër të tjera, citon se: “Unë i nënshkruari H.M, së bashku me shoqëruesen time dhe me z. A.M, me datë 07.09.2024, po udhëtonim nga Mollas për në Cërrik-Selitë, rreth orës 12.00, me autobusin me targë AA xxx UZ. Arritëm në Cërrik në orën 12.30 dhe në zbritje do bënim pagesën na thanë me zë të lartë, që nuk e njohim librezën për të udhëtuar me gjysmë bilete, por do paguani si gjithë të tjerët. U detyruam të paguanim biletën e plotë”.

Në përfundim ankuesi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave për shkak të tij.

<sup>1</sup> Referuar Librezës së Verbërisë të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, nr. 13135, datë 01.07.2010, z. H.M është i verbër Grupi I.

Referuar Librezës së Verbërisë të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, nr. 23268, datë 21.01.2012, z. A.M është i verbër Grupi II.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri konstatoi se ajo ka mangësi të anës formale që lidhen me faktimin apo provueshmërinë e pretendimit të diskriminimit nga ana e faturinos së autobusit me targë AAxxxUZ, që ofron shërbimin në linjën e transportit urban Mollas-Cërrik.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qëndrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit subjekti ankues është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Në nenin 33/5 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Personat fizikë ose juridikë, kundër të cilëve është paraqitur ankesa, njoftohen me shkrim nga Komisioneri brenda 15 ditëve nga marrja e ankesës”*.

Neni 91/3 të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se: *“Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”*.

Në ankesën e regjistruar pranë KMD-së, ankuesit kanë pretenduar trajtim të padrejtë nga ana e faturinos (punonjës i Kompanisë që ofron shërbimin e transportit urban në linjën Mollas-Cërrik), lidhur me mosnjohjen nga ana e tij e librezave të verbërisë që ata ka paraqitur.

- Lidhur me provueshmërinë e këtij momenti i cili lidhet drejtpërdrejtë me pretendimin e ankuesve për diskriminim, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 1248/1, datë 17.09.2024, ka kërkuar nga subjektet ankues, të sqarojnë si më poshtë citohet:

*“Cilin dokument keni paraqitur faturinos së autobusit: Librezën e Verbërisë së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo Librezën e Verbërisë së lëshuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve, si dhe të depozitoni një kopje të Librezës së paraqitur.*

*Gjithashtu, të depozitoni biletën e udhëtimit Mollas-Cërrik, në datën e cituar prej jush, 07.09.2024, nëse e dispononi”.*

Nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 1246/2, datë 23.09.2024, ankuesi H.M ka informuar Komisionerin se, ka paraqitur faturinos të dyja librezat e verbërisë edhe atë të Shoqatës, edhe atë të Shërbimit Social Shtetëror, ndërsa biletat nuk i disponon për shkak se nuk është pajisur me biletë nga faturinoja.

Nëpërmjet shkresës me nr. 1248/2, datë 25.09.2024, Komisioneri ka kërkuar nga Bashkia Cërrik, informacionin e mëposhtëm:

- *“A është linja e transportit të udhëtarëve Mollas-Cërrik dhe anasjelltas, subjekt licencimi nga ana e Bashkisë Cërrik? Nëse po, cila shoqëri është licencuar dhe operon apo ka operuar në këtë linjë, në periudhën e pretenduar se ka ndodhur diskriminimi, datë 07.09.2024?*
- *Kopje të kontratës dhe/ose licencës, apo ndonjë akti tjetër, mbi bazën e të cilit rregullohet marrëdhënia dhe ofrimi i shërbimit nga operatori i shërbimit urban që mbulon këtë linjë.*
- *Informacion në pronësi të cilit subjekt është mjeti autobus me targa AA xxx UZ, shoqëruar me kopje të dokumentacionit përkatës të pronësisë.*
- *A është automjeti e mësipërm, i certifikuar nga autoriteti kompetent i licencimit, për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse në linjën Mollas-Cërrik dhe anasjelltas?*
- *Informacion cilat janë masat e ndërmarra (apo që do të ndërmerren në vijim) nga ana e Bashkisë për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga shtetasi H.M dhe A.M? Parashtrimet tuaja dhe aktet shkresore provuese, nëse ka.”*
- Në mungesë të përgjigjes nga ana e Bashkisë Cërrik, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1248/4, datë 17.10.2024, ka kërkuar sërish informacionin dhe dokumentacionin respektiv (sipas shkresës me nr. 1248/2, datë 25.09.2024).
- Me shkresën me nr. 2237/1, datë 04.10.2024, Bashkia Cërrik ka informuar Komisionerin se, pas verifikimit të bërë prej tyre, ka rezultuar se pretendimi i ankuesve ishte i vërtetë dhe se lidhur me këtë fakt kanë kryer bisedime me Administratorin e Shoqërisë “Bafna” shpk, e cila operon për linjën rrethqytetase, konform licencave të lëshuara nga ana e Bashkisë Cërrik.
- Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 180, datë 11.11.2024, të Komisionerit, në

---

<sup>2</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

datën 20.11.2024, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Bashkisë Cërrik.

Objekti i inspektimit ishte, ndër të tjera, marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, lidhur me parashikimet e bëra nga ana e Bashkisë Cërrik, në kuadër të masave konkrete për zgjidhjen afatgjatë të problematikës së parashtruar nga subjekti ankues.

Gjatë inspektimit me përfaqësuesin e Bashkisë, z. K.B, me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e të Ardhurave, nga inspektorët e KMD-së, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua fakti se, nga ana e Bashkisë Cërrik, ekziston vullneti për të zgjidhur situatën konkrete dhe për të përmbushur detyrimin ligjor për t'i siguruar shërbimin përkatës dhe dinjitoz kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuara (PAK).

Në këtë kuadër, nisur nga ankesa konkrete, z. B, shprehet se: *“...në Këshillin Bashkiak është diskutuar mundësia për të buxhetuar një fond të posaçëm për rimbursimin e pagesës për PAK, për shoqëritë e transportit të udhëtarëve që operojnë në juridiksionin e Bashkisë Cërrik. Ky fond ka për qëllim të mundësojë rimbursimin e shpenzimeve të shoqërive të transportit publik, për të ofruar shërbime të transportit pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara. Ky rimbursim do të realizohet në përputhje me ligjin dhe aktet përkatëse që mbështesin përfshirjen dhe trajtimin e barabartë të kësaj kategorie, duke siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësinë të shfrytëzojnë transportin publik pa pagesë, si pjesë e përpjekjeve për të garantuar barazinë dhe aksesin me dinjitet në shërbime publike.*

*Nga ana e Bashkisë Cërrik është realizuar gjithashtu, një takim me përfaqësuesit e Shoqërive të Transportit Publik që operojnë në Bashkinë Cërrik, të cilët, gjatë takimit u dakordësuan që, në vijim, personave me AK do t'u afrohet ky shërbim pa asnjë pagesë, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.*

*Në cilësinë e provës për të vërtetuar hapat e ndërmarrë nga Bashkia, do të dërgojmë pranë Komisionerit, projekt-vendimin e Bashkisë për vitin 2025, ku të jetë parashikuar sa më sipër.”*

- Në vijim, nëpërmjet e-mail-it datë 30.12.2024, z. B, me detyrë Përgjegjës Sektori/Drejtoria e të Ardhurave Vendore, pranë Bashkisë Cërrik, ka dërguar pranë Komisionerit, Vendimin e Këshillit Bashkiak Cërrik me nr. 80, datë 27.12.2024, me objekt: *“Për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2025”*, duke cituar ndër të tjera se:

*“Paketa risi për Vitin 2025: 0 lekë udhëtimi me autobuza për linjat urbane për persona me aftësi të kufizuara grupi 1, 0 lekë taksat e drejtpërdrejta si dhe tarifatat vetëm 300 lekë pastrim, 100 lekë ndriçim, 100 lekë gjelbërim simbolike, nëse i paguajnë brenda muajit mars, edhe 500 lekët paguhen me 20% ulje. Kjo risi këtë vit si në pak Bashki të Shqipërisë”.*

Ky dokument, në faqen 33, të tij, parashikon lehtësirat fiskale për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me transportin rrethqytetas, ku personat do të udhëtojnë pa biletë (konform paraqitjes së

dokumentacionit përkatës që provon aftësinë e kufizuar), vlerë e cila do t'i subvencionohet shoqërive të transportit nga Bashkia Çërrik, (sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 224, datë 13.04.2022).

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet parashikimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin e tij në linjat urbane rrethqytetase, pa biletë, pra pa asnjë kosto financiare.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e Bashkisë Çërrik, përmes parashikimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin e PAK, në linjat urbane rrethqytetase, pa biletë dhe rimbursimin e kostove përkatëse për shoqëritë e transportit urban;
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, si dhe
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 188, datë 11.09.2024, të paraqitur nga z. H.M dhe z. A.M kundër linjës së transportit të udhëtarëve Mollas-Cërrik, duhet të deklarohej e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur<sup>3</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,  
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 188, datë 11.09.2024, të z. H.M dhe z. A.M pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>3</sup> Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024.